

VASIJETI I IMAM ADHAMIT

(Ebu Hanifes) për Ebu Jusufin

(Nga libri “El Eshbah ve Nedhair”, i alimit të madh hanefi: Zejnulabidin ibën Ibrahim, i njohur si Ibën Nuxhejm, *rahimehullah*).

Me koment të Hibetullah Et Taxhi El Hanefij,
rahimehullah.

وصية الإمام الأعظم لأبي يوسف

من كتاب الأشباه و النظائر لابن النجيم الحنفي
بشرح هبة الله التاجي الحنفي

الترجمة باللغة الألبانية

زيد ابن أنور حزيري

VASIJETI I IMAM ADHAMIT

(Ebu Hanifes)

për Ebu Jusufin

Përktheu dhe përshtati:

Zejd Haziri

Shtëpia botuese:

Botimet Udhaebesimtarëve, Tiranë

Redaktor gjuhësor:

Besnik Jaha

Desing:

MEBA design

Formati:

B6

Tirazhi:

250 copë

Shtypi:

“Mileniumi i Ri”, Tiranë

Viti i botimit:

2023

© Botimet Urtësia. Të gjitha të drejtat e botimit dhe publikimit të tërësishëm apo të pjesërishtëm, janë të rezervuara dhe të mbrojtura me ligj!

PARATHËNIE

Të nderuar lexues, para jush keni një vasijet të dobishëm përplot me këshilla, edukatë, moral e urdhërim në të mirën dhe ndalim nga e keqja, vasijet ky që prek kategori të ndryshme të myslimanëve, e posaçërisht ata që merren me shërbimin e myslimanëve sikurse: imamët, mualimët, hoxhallarët, dijetarët e gjykatësit myslimanë në shoqëritë islame. Vasijeti pasqyron në vete raportin e krijesës me Krijuesin, dhe krijesës me krijesën. Dhe, si i këtillë që është, dobia e leximit dhe e përvetësimit të këtij vasijeti ka peshë të madhe në jetën myslimanit në përgjithësi, dhe në atë të shërbyesit të popullit në veçanti.

Çka do të thotë vasijet?

Fjala *vasijet* rrjedh nga arabishtja, që do të thotë: porosi me udhëzime, sugjerim, testament me nene që e porosisin atë që i dedikohen t'iu përmbahet atyre neneve, e të cilat janë në të mirën e tij; apo letër që përmban këshilla të ndryshme në të mirën e atij që i adresohet, apo urdhërim për të mirë dhe ndalim nga e keqja.

Vasijeti është përmendur në Kuran në disa ajete, madje edhe në mënyrë direkte, po edhe përmbajtësore, dhe po ashtu edhe në Sunetin e Pejgamberit, *salAllahu*

alejhi ve selem. Për shembull, Allahu i Lartësuar thotë në Kuran:

وَوَصَّىٰ بِهَا إِبْرَاهِيمُ بَنِيهِ وَيَعْقُوبُ يَا بَنِيَّ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ لَكُمُ الدِّينَ فَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ

“E Ibrahim i porositi bijtë e tij me këtë (fe), e edhe Jakubi, (u thanë): O bijtë e mi, Allahu e zgjodhi fenë (Islame) për ju, prandaj mos vdisni ndryshe, por vetëm se duke qenë myslimanë!” | El Bekare: 132.

Dhe thotë:

وَالَّذِينَ يَتُوفَوْنَ مِنْكُمْ وَيَذَرُونَ أَزْوَاجًا وَصِيَّةً لِأَزْوَاجِهِمْ مَتَاعًا إِلَىٰ الْحَوْلِ غَيْرَ إِخْرَاجٍ

“Ata që vdesin nga mesi i juaj, dhe lënë pas vete gra, le të testamentojnë (lënë porosi) për gratë e tyre, furnizimin për një vit, duke mos i nxjerrë nga shtëpia.” | El Bekare: 240.

Dhe thotë:

وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ وَلَقَدْ وَصَّيْنَا الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَإِيَّاكُمْ أَنْ اتَّقُوا اللَّهَ

“Vetëm e Allahut është ç’ka në qiej dhe ç’ka në Tokë. Ne i patëm sugjeruar ata që iu qe dhënë libri para jush, e edhe juve, që ta kini frikë Allahun.” | En Nisa:131.

Dhe thotë:

وَإِذْ قَالَ لُقْمَانُ لِابْنِهِ وَهُوَ يَعِظُهُ يَا بُنَيَّ لَا تُشْرِكْ بِاللَّهِ

“Kur Llukmani, duke e këshilluar birin e vet, i tha: O djali im, mos i përshekruaj Allahut ortak...!” | Lukman: 13.

Dhe thotë:

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ حَلْتَهُ أُمَّهُ وَهَنَّا عَلَى وَهْنٍ وَفَصَالُهُ فِي عَامَيْنِ
أَنْ اشْكُرْ لِي وَلِوَالِدَيْكَ إِلَيَّ الْمَصِيرُ

“Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindërit të vet, sepse nëna e vet atë e barti me mund pas mundi, dhe pas dy vitesh e ndau nga gjiri. (E porositëm) Të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu, sepse vetëm tek Unë është kthimi juaj!” | Lukman: 14.

Kurse nga Suneti po e përmendim hadithin e Ebu Hurejres, *radijallahu anhu*, i cili thotë: “I dashuri im, Pejgamberi, *salAllahu alejhi ve selem*, më porositi me tri gjëra: Të agjëroj tri ditë nga çdo muaj, t’i fali dy rekate të Duhasë, dhe ta fali (namazin) e vitrit (tek) para se të fle”. Hadithin e transmeton Muslimi, (721).

Kush është Imam Adhami?

Me Imam Adhamin është për qëllim Imam Ebu Hanife, *Allahu e mëshiroftë*, Imami i drejtimit juridik fetar hanefij, i cili është i njohur për lexuesin shqiptar, meqë në vendet tona ky drejtim është i shtrirë dhe praktikohet prej besimtarëve myslimanë te ne. Dhe titulli “Imam Adhami” është titull i përdour prej ndjekësve të këtij drejtimi juridik, e që do të thotë: Imami më i madh.

Imam Ebu Hanife, Nuëman ibën Thabit El Kufi, është i lindur në vitin 80 hënor, ose në vitin 699 gregorian, në Kufe. Ky është fekih, dijetar i madh mysliman, i pari i katër imamëve të Ehlu Sunetit dhe Xhematit, si dhe Imam i medhhebit hanefij në fikhun islam. Ai u shqua me dijen e tij të madhe dhe moralin e tij të lartë. Ebu Hanife, *rahimehullah*, llogaritet se është prej gjeneratës së tabiinjve, meqë i takoi disa sahabët (shokë të Pejgamberit, *salAllahu alejhi ve selem*), prej tyre Enes ibën Malik etj. Ai vdiq në vitin 150 hënor, Allahu e pastë mëshiruar!

E, ky imam e shkroi këtë vasijet për nxënësin e tij të afërt, Jakubin, apo Ebu Jusufin, *rahimehullah*, i cili po ashtu ishte i shquar me dijen dhe autoritetin e tij si gjykatës suprem në atë kohë.

Ebu Jusuf El Ensari, nxënës i Imam Ebu Hanifes, u lind në vitin 113 hixhrij, në qytetin Kufe, dhe qysh herët e memorizoi Kuranin dhe iu përkushtua mësimin të gjuhës arabe, Fikhut dhe Usulit, si dh u shqua me zgjuarsinë e tij të madhe. Ai iu bashkua mësimëve të Ebu Hanifes, dhe për të u përkujdes vetë Imam Ebu Hanife, *rahimehullah*, duke ia garantuar një përkrahje financiare, meqë Ebu Jusufi vinte nga një familje e varfër, dhe kështu ky iu përkushtua dijes dhe e shoqëroi Ebu Hanifen për 20 vjet pandërprerë.

Dashuria e madhe për dije dhe avancim e shtyri Ebu Jusufin që të shkojë në Medinen e Pejgamberit, *salAllahu*

alejhi ve selem, ku edhe i mori mësimet në Hadith dhe Fikhu, prej Imam Malikut, *rahimehullah*, e më pas u kthye në Irak dhe u mor me mësimdhënie, ku edhe iu dha posti i gjykatësit, në vitin 166 hënor, në kohën e kalifit abasid El Mehdij. Më vonë iu dhurua edhe posti i gjykatësit suprem, pra në kohën e kalifit Harun Reshid. Dhe, kjo ishte hera e parë që dikujt i jepej ky post në historinë e gjykatës islame. Imam Ebu Jusufi, *rahimehullah*, umetit islam i la trashëgimi një libër shumë të dobishëm, librin “El Harraxh”, dhe ishte i shquar me dije në fusha të ndryshme të shkencave fetare, si dhe ishte njëri prej dijetarëve më të shquar të medhhebit hanefij. Ai vdiq në vitin 182 hënor, Allahu e pastë mëshiruar.

Këtë vasijet, të cilin e keni para vetes, e ka sjellë dijetari i madh hanefij, Ibën Nuxhejmi, *rahimehullah*, në librin e tij “El Eshbah ven Nedhair”, dhe e ka shpjeguar Hibetullah Et Taxhi El Hanefij, në komentin e tij “Et Tahkik El Bahir”. Prandaj, ajo që gjendet në fusnota nga shpjegimet janë punë e Et Taxhit, kurse porosinë brenda tekstit janë vasijeti që e ka sjellë Ibën Nuxhejmi, pra në librin e vet. Dhe, ky vasijet i Imam Ebu Hanifes, *rahimehullah*, është marrë nga katër dorëshkrimet më të mira të gjetura dhe të lexuara, siç thotë edhe recensuesi i librit të Taxhit, Dr. Usame Muhamed Shejh.

Ky vasijet në gjuhën shqipe do të titullohej: “Porosinë e Imamit më të madh”, mirëpo meqë Ebu Hanife, *rabi-*

mehullah, njihet edhe tek ne me llogabin “Imam Adhami”, e pamë të rrugës ta titullojmë sipas origjinalit, meqë edhe fjala vasijet tanimë është e njohur te myslimanët e trevave tona.

Allahun e Madhëruar e lus që kjo përshtatje imja nga gjuha arabe e këtij vasijeti të jetë e dobishme për lexuesit tanë, dhe që ta pranojë e ta llogaritë si sadaka rrjedhëse, si dhe të na bëjë dobi në atë Ditë kur nuk bën dobi as pasuria e as evladi, por vetëm puna e atij që paraqitet me zemër të shëndoshë e me vepra të mira! E, sukcesi është vetëm prej Allahut të Lartmadhëruar!

Zejd Haziri

16/3/1444 hixhrij, apo 11/10/2022

Gjilan, Kosovë.

VASIJETI I IMAM ADHAMIT (EBU HANIFES) PËR EBU JUSUFIN

Porosia e Imam Adhamit, Ebu Hanifes, *rahimehullah*, drejtuar Ebu Jusufit, *rahimehullah*, pasi Imami pa tek ai shenjat e maturisë dhe të sjelljes shembullore, si dhe interesimin e tij për njerëzit.

Ai, *rahimehullah*, i tha atij:

- “O Jakub¹, respektoje prijësin (sulltanin), dhe madhësoje pozitën e tij, kujdes nga gënjeshtria para tij dhe kujdes nga hyrja tek ai në çdo çast, përveçse nëse të ka thirrur për ndonjë çështje shkencore²! Pastaj, nëse ti e shpreshton shoqërimin me të, ai do të të anashkalojë, dhe pozita jote tek ai do të zvogëlohet. Kështu që, mbaji raportet me të ashtu siç je me zjarrin! Përfito dhe rri në distancë, mirëpo mos iu afro shumë, sepse prijësi nuk e sheh askënd më lart sesa veten! Kujdes nga të qenët llafazan para tij, sepse ai të qorton (apo të

1 Jakub ishte emri i Ebu Jusufit, *rahimehullah*.

2 Mundohu ta shoqërosh për dije, e jo për çështje të dynjasë!

hakmerret) për fjalët që i thua para tij, që të tregojë para vartësve të tij se është më i mençur sesa ti¹ dhe se ai të gjeti ty gabime, dhe që të të shfaqë ty të vogël në sytë e njerëzve! Kur të hysh tek ai, ta kesh parasysh vlerën tënde! Dhe njihe vlerën e të tjerëve, dhe mos hyr tek ai kur aty gjendet dikush tjetër prej njerëzve të dijës e që nuk i njeh, sepse nëse ti je më poshtë se ai me pozitë, ndoshta ngrihesh, dhe kjo të bën dëm, e nëse je më i ditur sesa ai, ndodh që ta nënçmosh atë, e pastaj ta humbësh vlerën nga syri i prijësit²! Nëse ai të ofron diçka nga punët e tij, mos e prano³ përveçse pasi ta dish se ai është i kënaqur me ty dhe me drejtimin tënd në dije dhe gjykime⁴, në mënyrë (me kusht) që mos ta ndërrosh drejtimin tënd e t'i ndjekësh drejtimet e të tjerëve⁵ nëpër qeveri!

1 Me pretekstin se ai e ka kuptuar atë që nuk e ke kuptuar ti.

2 E kështu bëhet i ulët para tij.

3 Në një hadith që e transmeton Taberiu, në "Mexhmeaz Zevaid", (9258), dhe e saktësoi Albani në "Sahihul Xhami", (2672), thuhet: "Kujdes nga dyert e sunduesit (sulltanit), sepse ato ta japin përfundimin e keq (në dynja dhe në ahiret)!". Ndërsa, në një transmetim tjetër, të transmetuar prej Ahmedit, dhe të saktësuar prej Albanit, thuhet: "Kush shkon te dyert e sunduesit (punësohet prej tij), ai do të sprovohet (do të ndryshojë)". Komentuesit e këtij hadithi kanë thënë: "Sepse nëse i nënshtrohesh, e ndërron fenë, nëse jo, atëherë e humb dynjanë tënde."

4 Atëherë pranoje ofertën e tij si gjykatës.

5 Për të cilat nuk je i sigurt nëse janë të sakta, ose nuk i njeh fare.

- Mos mbaj lidhje (mos u shoqëro) me miqtë e tij, e as me vartësit e tij, mirëpo vetëm atij afroju (siç i afroresh zjarrit), dhe rri larg vartësve të tij, që të zgjasë krenaria dhe autoriteti yt¹!
- Mos fol para njerëzve të rëndomtë² përveçse për atë që pyetesh (nga çështjet e fesë), ruaju nga të folurit para njerëzve dhe para tregtarëve, përveç nëse flitet për dije, në mënyrë që lakmia jote për pasuri³ mos të jetë shkaktar për humbjen e dashurisë së tyre, e pastaj ata të mendojnë keq për ty, dhe të mendojnë se ti anon kah marrja e ryshfetit prej tyre! Po ashtu, as mos qesh dhe as mos u buzëqesh para njerëzve⁴!
- Dhe as mos e tepro me dalje në tregje⁵, e as mos u fol të miturve, sepse ata janë shkak i sprovës⁶, por s'ka të keqe nëse u flet fëmijëve dhe ua ledhaton kokat⁷! Dhe as mos ec në mes të rrugës me pleqtë

1 Ngase afrimi me ta i shtyn ata të të nënçmojnë dhe të flasin për ty te sunduesi, pra me gjëra të pahijshme, e kjo të kishte ndikuar ta humbësh prestigjin që e ke.

2 Pasi e dëftoi se si të shoqërohet me sunduesin dhe vartësit e tij, tani e dëfton se si të shoqërohet me të tjerët.

3 Pra, e folura jote para tyre për tregti, jashtë dijes, mos të kuptohet tek ata se ti je lakmitar i pasurisë, sepse kjo pastaj bëhet shkaktar që ta humbësh dashurinë e tyre.

4 Që mos të të nënçmojnë pastaj ty, sepse ajo është shenjë e çalimit tënd.

5 Sepse janë vende të shkujdesjes nga përmendja e Allahut.

6 I joshjes e trazimit nga sjellja e butë që mbajnë, pastërtia, çiltërsia e padjallëzia.

7 Siç vepronte Pejgamberi ynë, Muhamedi, *salAllahu alejhi ve selem*, i cili

dhe njerëzit e rëndomtë, sepse nëse ti u jep përparësi, kjo ta nënçmon dijen tënde, e nëse i lë mbrapa e nënçmon veten meqë ai është më i moshuar sesa ti¹! Pejgamberi, *salAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “Kush nuk i mëshiron të vegjilit tanë, e as nuk i respekton të moshuarit tanë, nuk është prej nesh.”².

- Dhe mos u ul në mes të rrugës³! E nëse e ke patjetër, atëherë ulu në xhami⁴! Dhe mos ha në tregje e as në xhamia⁵!

luante me fëmijët e Medines. Për më shumë shih: “Shemail Muhamedije” të Tirmidhiut!

- 1 Pra, në të dy rastet ka nënçmim për ty si gjykatës (kadi) dhe dijetar, prandaj shmangu nga ecja me ta!
 - 2 Transmetuesit janë: Ebu Davudi (4943), Tirmidhiu (2002), si dhe të tjerët. Hadith është autentik.
 - 3 Meqë kjo ta ulë pozitën.
 - 4 Kjo komentohet nëse e shqetëson dikë me uljen tënde rrugëve, ose kur ti mund të dëmtohesh. Përndryshe, në një hadith të Tirmidhiu, në “Shemail Muhamedije” (331) transmetohet prej Enesit, *radijallahu anhu*, se një grua kishte shkuar tek i Dërguari i Allahut, *salAllahu alejhi ve selem*, dhe i kishte thënë: “Unë kam nevojë që të më ndihmosh për diçka!”. Ai, *salAllahu alejhi ve selem*, i kishte thënë: “Ulu në cilëndo rrugë të Medines që dëshiron, e do të ulem te ti!”. Hadithin e transmeton po ashtu edhe Ebu Davudi (4818), dhe me kuptim të njëjtë, mirëpo me fjalë të tjera e transmeton Muslimi, në koleksionin e tij (2326).
- Normat e qëndrimit në rrugë i ka sqaruar Pejgamberi, *salAllahu alejhi ve selem*, në një hadith, i cili transmetohet prej Ebu Seid El Hudrij, *radijallahu anhu*, se Pejgamberi *salAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “Kujdes nga ulja rrugëve!”. I thanë: “O i Dërguar i Allahut, po nëse e kemi patjetër për t’u ulur dhe për të biseduar?”. I Dërguari i Allahut tha: “Nëse e keni patjetër, atëherë përmbajuni normave të saj!”. Ata thanë: “E cilat janë ato, o i Dërguar i Allahut?” Ai tha: “Ulja e shikimit, mosbërja keq, kthimi i përshëndetjes me selam, thirrja në të mirë dhe ndalimi nga e keqja.”. Hadithin e transmeton Buhariu dhe Muslimi.
- 5 Mos ha në xhami sepse ngrënia në të është shenjë e mungesës së edukatës

- Mos pi nga çezmat¹, e as nga duart e shpërndarësve të ujit! Dhe as mos u ul nëpër dyqane, dhe as mos vesh mëndafsh e stoli², si dhe as nga llojet e mëndafshit të trashë, sepse kjo shpie në mendjelehtësi³!
- As mos fol shumë me gruan tënde në shtëpi, përveç kur ke nevojë për të, vetëm aq, dhe as mos e shpeshto prekjen e saj dhe as mos iu afro⁴ përveçse duke e përmendur Allahun e Lartësuar! As mos fol me të për çështjet e grave të tjera, apo para saj, dhe as për çështjet e vajzave, sepse ajo pastaj lirohet me ty në bisedë, dhe ndodh që kur të flasësh për të tjerat⁵ edhe ajo pastaj njësoj flet për burrat e huaj!

ndaj shtëpisë së Zotit, meqë xhamia është vend i adhurimit, kurse në tregje, sepse e dëmton autoritetin. E Pejgamberi, *salAllahu alejhi ve selem*, në një hadith thotë: “*Vendet më të mira (për të qëndruar në to) janë xhamitë, kurse vendet më të këqija (në tokë) janë tregjet.*”, Hadithin e transmeton Hakimi, në Mustedrek (2149), dhe e saktësoi Dhehebiu.

- 1 Në realitet pirja nga to lejohet për të pasurit dhe për të varfrit, mirëpo qëllimi i autorit është se nuk është e pëlqyer për dijetarin, sepse kjo, po ashtu, e ul autoritetin dhe respektin e dijetarit.
- 2 Dihet se është natyrë e grave dekorimi me stoli dhe elmaze.
- 3 Mburria me rroba nuk është virtyt i nderit dhe i madhësisë, por është nga cilësitë e grave. Qëllimi në rroba është pastërtia dhe mesatarja, siç kuptohet nga hadithet e Pejgamberit, *salAllahu alejhi ve selem*.
- 4 Pra, mos bëj marrëdhënie intime me gruan tënde pa e përmendur Allahun e Madhëruar, siç transmetohet në Sahihun e Buhariut (141), se Pejgamberi, *salAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Kur ndokush prej jush dëshiron të bëjë marrëdhënie me gruan vet, le të thotë: “Bismilah, o Allahu ynë, largoje shejtanin prej nesh prej atij (asaj) që do të na furnizosh...!”.*”
- 5 Me diçka të pahijshme.

- Dhe nëse mundesh, mos e marto një grua që kishte më herët një burrë, ose që ka baba, ose nënë, ose vajzë! Ose martoje atë (që i ka ata të afërm), veçse me kusht që mos të hyjë tek ajo askush prej të afërmeve të saj¹! Meqë, nëse gruaja është e pasur, dhe ka baba ose nënë, babai ose nëna e saj do të pretendojnë se e tërë pasuria e saj është e tyre (ose e saj), dhe se ajo është vetëm si huazim tek ajo (gruaja)²!
- Po ashtu, sa më pak të hysh në shtëpinë e babait të saj³, dhe kurrësi mos prano të martohesh (e banosh) në shtëpinë e prindërve të saj, sepse ata ta marrin pasurinë dhe kanë lakmi të madhe për të!
- Ki kujdes e mos e marto dikë që ka djem e vajza, sepse ajo krejt pasurinë do ta ruajë për ta, dhe do ta vjedhë pasurinë tënde për ta shpenzuar me ta, meqë fëmija për të është më i rëndësishëm dhe më i dashur sesa ti!

.....
1 Qëllimi i autorit është që mos të martojë grua me shumë të afërm, në mënyrë që ata mos të ndërhyjnë në jetën personale të burrit, dhe meqë ky si dijetar e gjykatës është i nxënë me punët e tij sublime.

2 Si pasojë ai do ta marrë atë prej teje kurdo që dëshiron, dhe kështu do të dëshpërohesh.

3 Në mënyrë që ai mos të mendojë se ti ke nevojë për të.

- Dhe mos i bashko dy gra brenda një shtëpie¹, si dhe mos u marto përveçse pasi të jesh i bindur se mund t'i përmbushësh të gjitha nevojat e saj²!
- Së pari kërkoje dijen³, e pastaj tubo nga pasuria e lejuar (hallall)⁴! Pas këtyre (angazhimeve) mar-tohu, sepse nëse e kërkon pasurinë në kohën e arsimimit, s'do të mund të kërkoksh dije, dhe pasuria të nxitë në blerjen e robërshave dhe shërbëtorëve, e kështu preokupohesh me dynja dhe gra para se të arrish dije! Kështu e humb kohën tënde, sepse të mblidhen fëmijët dhe të shtohet familja, dhe ke nevojë të merresh me leverditë e tyre, dhe kështu ta braktisësh dijen.
- Prandaj, merru me dije në fillim të rinisë tënde, dhe kur zemra dhe mendja jote të jenë të lira⁵, më pas puno në arritjen e pasurisë për veten, meqë fëmijët e shumtë dhe familja ta angazhojnë men-

1 Këtu janë për qëllim vendet ku ato e zhvillojnë jetën e tyre, pra të jetë e ndarë, të ketë ose objekt më vete, apo brenda një objekti mirëpo me dhoma të ndara më vete, kuzhinë më vete, hyrje e dalje më vete etj.

2 Nevojat përfshijnë shpenzimet, mehrin dhe anën biologjike (marrëdhëniet intime), e që do të thotë se, nëse nuk ka mundësi t'i plotësohen asaj këto nevoja, atëherë personit nuk i lejohet të martohet, në mënyrë që mos të jetë i padrejtë ndaj saj.

3 Meqë kërkimi i dijes para martesë është më i lehtë, sepse në atë kohë je më pak i zënë me preokupime e detyrime sesa pas martesës.

4 Pra, puno me punë hallall, në mënyrë që të tubosh pasuri hallall!

5 Siç transmetohet prej Umerit, *radijallahu anhu*, se ka thënë: "*Mësojeni (fenë) para se të plakeni!*". Hadithin e transmeton Buhariu, në kapitullin e dijes, në Sahihun e tij.

djen! Dhe, pasi të bësh pasuri, martohu, si dhe kije frikë Allahun e Lartësuar në përmbushjen e amaneteve¹ dhe këshillimin e të gjithëve, të veçantëve dhe të rëndomtëve²!

- Assesi mos i përbuz njerëzit, dhe nderoje veten dhe ata, duke mos e shpeshtuar shoqërimin me ta³, përveçse pasi ta kërkojnë ata shoqërimin me ty⁴! Pranoje shoqërimin e tyre duke i përmendur çështjet (e fesë)! Nëse ai (shoqëruesi) është prej admiruesve të dijes, do të angazhohet me dije, e nëse jo, së paku ka për të të dashur ty (për dobitë fetare që ia ke përmendur).
- Dhe kurrsesi mos u fol njerëzve të rëndomtë për çështje të fesë, e që kanë të bëjnë me apologjetikën,

1 Qofshin ato amanete të krijesave, apo të Krijuesit; amanetet ndaj Krijuesit përfshijnë të gjitha nënshtrimet ndaj Tij, kurse amanetet ndaj krijesave përfshijnë huazimet, pengjet materiale, dhëniet materiale për siguri, si dhe garancitë e tjera.

2 Meqë “*Feja është këshillë*”, siç transmetohet prej Muslimit (55), prej Temim Ed Darij, *radijallahu anhu*.

3 Mos u përziej shumë me ta, sepse përzierja me ta pa kurrfarë dobie ta shpenzon jetën, dhe më vonë mund të jesh pishman tërë kohën për humbjen kot të kohës.

4 Për ndonjë dobi të ahiretit apo të dynjasë, përndryshe, siç thotë Pejgamberi, *salAllahu alejhi ve selem*: “*Mos e shoqëro përveçse besimtarin, dhe mos ta hajë ushqimin tënd përveçse i devotshmi!*”. Hadithin e transmeton Ebu Davudi (4832). Kurse në një transmetim tjetër thuhet: “*Shembulli i shokut të mirë është sikurse i atij që shet parfume. Nëse nuk përfiton diçka prej tij, së paku të vjen aroma e këndshme. Kurse shembulli i shokut të keq është sikurse shembulli i farkëtarit. Nëse nuk përlyhesh nga ngjyra e zezë e tij, së paku (të vjen era) tymi i tij.*”. Hadithin e transmeton Ebu Davudi (4289).

sepse ata të imitojnë verbërisht, e pastaj angazhohen me të¹!

- Kush vjen te ti për të kërkuar fetva për çështje (shkencore fetare), përgjigju vetëm në pyetjen e tij, dhe mos shto diçka tjetër më shumë, sepse kjo ia bën edhe më të paqartë përgjigjen për pyetjen e tij²!
- Pastaj, nëse mbetesh dhjetë vjet pa libra dhe fuqi (trupore)³, mos ia kthe shpinën dijes, në të kundërtën jeta jote do të ketë ngushtime (vështirësi)⁴, dhe ata që e kërkojnë prej teje mësimin e fesë, secilin prej tyre konsiderojë sikur të ishte djali yt⁵, në mënyrë që kjo sjellje jotja tua shtojë atyre dëshirën për dije⁶!

1 Dijetarët e selefit e kanë ndaluar preokupimin me apologetikën, sikurse ishin: Ebu Hanife, Shafiu, Ahmedi, Hasani e të tjerët, sepse apologetika e dëmton besimin e myslimanit pasi ai përmes saj zhytet në pështjellimet e filozofëve.

2 Edhe pse kjo në realitet është e lejuar, siç e shënon Buhariu në Sahihun e tij (134), prej Ibën Umerit, *radijallahu anhuma*, se një njeri e kishte pyetur Pejgamberin, *salAllahu alejhi ve selem*, se çfarë duhet veshur muhrimi (personi që i vesh ihramët për ritualet e haxhit)?, e ai i kishte thënë: “*Nuk vesh këmishë, e as amame, dhe as pantallona...*”. Pra, shtoi në përgjigje më shumë sesa u pyet, si sqarim për pyetësin.

3 Ekzagjerim në shumicë.

4 Këtu është për qëllim se kur ia kthen shpinën dijes jeta jote do të ngushtohet, meqë në kërkim të dijes ka përmendje të vazhdueshme të Allahut të Madhëruar, ndjekje të udhëzimit të Tij etj. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran, në suren Taha, në ajetin e 124-të: “*E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, ai do të ketë jetë të vështirë (të ngushtë).*”.

5 Me buzëqeshje, modesti dhe butësi.

6 Allahu i Lartësuar, vetëm se e ka mësuar Pejgamberin e Tij me këtë moral të bukur, kur i ka thënë: “*Dhe tërhiqja vërejtjen farefisit tënd më të afërt! Dhe të jesh i butë ndaj besimtarëve që të pranuan ty!*” (Kuran, 26:214-215).

- Sa i përket atyre që të polemizojnë pahijshëm, e që janë nga radhët e injorantëve dhe njerëzve të tregjeve¹, mos reflekto ndaj tyre, sepse polemika me ata ta largon turpin nga fytyra²!
- Mos të të vijë turp para askujt gjatë përmendjes së të vërtetës (që bie në pajtim me realitetin), edhe nëse është prijësi (sulltani)!
- Mos u kënaq me adhurimet (nafilet, përveç farzeve) që praktikon ti, përveçse kur ato janë në sasi shumë më të madhe sesa të të tjerëve, dhe kur janë me plot ambicie dhe vendosmëri, meqë njerëzit e rëndomtë, nëse nuk të shohin ty në atë gjendje e me plot ambicie në adhurime, më shumë sesa që ata gjenden në ato, do të hamendësojnë se vullneti yt për adhurim e shtesë është i vogël, dhe do të mendojnë se dija jote nuk po të bëjë dobi më shumë sesa që u bëri atyre injoranca që gjenden në të!
- Nëse hyn në një vendbanim ku ka dijetarë, mos u mundo të veçohesh dhe ta lartësosh veten mbi ta, por sillu sikurse njëri prej tyre, që mos të mendojnë

1 Sepse Allahu në Kuran thotë: “...dhe shmangu prej të paditurve!” (Kuran, 7:199).

2 Pra, polemika me të tillët ta largon turpin, dhe ndodh që të tregohesh i pakujdesshëm nëse e zgjat debatin me të tillët, si dhe kjo edhe ta humb respektin që e ke fituar.

se ke si synim pozitën e tyre¹! Përndryshe, do të rebelohen kundër teje me armiqësi dhe poshtërim, dhe do të të akuzojnë në drejtimin tënd², e pastaj edhe njerëzit e rëndomtë (të atij vendi) do të rebelohen kundër teje, duke të shikuar vetëm me sy (dhe nuk do të të përkrasin përballë sulmuesve), dhe si pasojë do të jesh i akuzuar tek ata pa kurrfarë dobie (në prestigj dhe pozitën që kishe si synim me shoqërimin me ta).

- Nëse kërkojnë prej teje fetva në çështje të ndryshme (të fesë), përgjigju vetëm në atë që je pyetur, dhe (nëse të polemizojnë) mos i polemizo ata me debat dhe sfidë, por fol me ta vetëm me argument të qartë, si dhe mos i kritiko mësuesit e tyre, sepse do të të akuzojnë ty për injorancë³! Prandaj, ki kujdes prej njerëzve!
- Po ashtu, mbaje raportin me Allahun në fshehtësinë tënde, ashtu siç e mban në të jashtmen tënde⁴, sepse nuk ka për të dhënë fryt dija përveçse

1 Nxjerrjen e fetvave dhe autoritetin e tyre.

2 Si arsyetim i rebelimit dhe i nënçmimit ndaj teje.

3 Këtu ka paralajmërim për njeriun, të ruhet prej armiqve që nxitojnë në prishjen e punëve të tij, si dhe paralajmërim të ruhet prej ziliqarëve që kanë ndikim në shkatërrimin e tij, dhe që shpresojnë që të godasin për të bërë dëme, dhe që po ashtu janë të gatshëm në këto punë.

4 Pra, ashtu siç tregohesh i devotshëm në publik, po ashtu qëndro edhe në vetmi! Bëhu i sinqertë dhe besnik me Allahun në të gjitha rastet, para njerëzve, po edhe pa njerëz!

pasi e brendshmjaja jote të jetë sikurse e jashtmjaja jote!

- Më pas, nëse prijësi të angazhon me një punë, e që është e mirë për ty¹, nuk të lejohet ta pranosh atë prej tij përveçse pasi të jesh i bindur se ai të angazhoi me të për shkak të dijes tënde!
- Dhe assesi mos rri në ndejat e debateve me frikë, sepse kjo (qëndrimi me frikë) sjell defekt në përgjigje dhe dobësi në të shprehur²!
- Dhe, po ashtu, kujdes nga të qeshurit shumë, meqë të qeshurit (shumë) e bën zemrën të jetë e vdekur³!
- Mos ec ndryshe përveçse duke qenë i qetë⁴, dhe as mos ji i ngutshëm në çështjet tua (fjalët apo veprat)⁵! Dhe kur të flasësh, mos bërtit dhe as mos

1 Ngjashëm me këtë porosi ishte edhe një tjetër më lart, vetëm se këtu e ka kushtëzuar me “të mirë për ty”, e që do të thotë se, nëse nuk është punë e mirë, e lejuar, e dobishme, ajo edhe nuk duhet të pranohet. Pra, mos e prano!

2 E këto të dyja të thejnë dhe ta nënçmojnë dijen tënde.

3 Kjo porosi e Imam Ebu Hanifes është fragment i një hadithi që e transmeton Ebu Hurejre, *radijallahu anhu*, prej të Dërguarit të Allahut, *salAllahu alejhi ve selem*, të cilin e transmeton Tirmidhiu (2305), Ibën Maxheh (4217), dhe Ahmedi (8095), dhe të cilin e saktësoi Albani.

4 “Mos ec në Tokë me mendjemadhësi!”, (Kuran, El Isra: 37); dhe “Ec me kujdes e i përmbajtur!” (Kuran, Lukman: 19).

5 Në një dorëshkrim të vasijetit të Imamet gjendet edhe ky fragment: “Dhe kush të thërret nga pas, mos iu përgjigj, sepse vetëm kafshët thirren nga pas!”.

e ço zërin¹, mirëpo tregohu i matur dhe me lëvizje të kufizuara, që te njerëzit të vërehet vendosmëria jote!

- Shpeshtoje përmendjen e Allahut të Lartësuar në mesin e njerëzve, që ta përvetësojnë këtë vepër prej teje, dhe pas çdo namazi farz obligoja vetes leximin e diçkaje nga Kurani! Dhe përmende Allahun e Lartësuar si shenjë falënderimi për durimin që ta ka dhënë, si dhe për dhuntitë që t'i ka lënë në shfrytëzim²!
- Po ashtu, caktoji vetes ditë të caktuara brenda muajit për t'i agjëruar³, në mënyrë që edhe tjerët të të ndjekin ty në këtë vepër! Mbikëqyre veten nga të shëmtuarat (duke u larguar nga haramet dhe duke i zbatuar urdhrat), dhe rri vigilent në punët e hairit⁴, sepse përfiton me dijen tënde nga dynjaja jote dhe ahireti yt!

1 Sepse Allahu në Kuranin fisnik (31:19) thotë: "...dhe fol me zë të ulët, sepse zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!"

2 Allahu i Madhëruar thotë në Kuran (14:34): "*Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, s'do të mund t'i numëroni dot.*"

3 Pejgamberi, *salAllahu alejhi ve selam*, i tha sahabiut, Ebu Dherrit: "*Nëse agjëron gjatë muajit, agjëroje ditën e trembëdhjetë, të katërmëdhjetë e të pesëmbëdhjetë!*". Hadithin e transmeton Tirmidhiu (761), si dhe të tjerët, ndërsa e saktësoi Albani.

4 Allahu i Lartësuar thotë: "*...dhe bëni vepra të mira, që ju të shpëtoni!*" (Kuran, 22:77).

- Mos i kryej punët e blerjes dhe të shitjes vetëm, por angazhoje një djalosh të devotshëm që t'i kryejë punët tua, dhe që të mbështetesh në të!
- Kujdes, mos u kënaq me dynjanë tënde, dhe as mos u rehato me gjendjen tënde në të cilën je¹, sepse Allahu ka për të të kërkuar llogari për të gjitha këto²!
- Si dhe mos blej (merr pranë për punët e blerjes) djalosh të papjekur, e as mos e shfaq nga vetja jote afrimin me prijësin, edhe nëse ai të afron, sepse ky afrim me të do të jetë shkak që të të paraqiten nevojat (e njerëzve), të cilat nëse ti ua përmbush, ai do të të nënçmojë, kurse nëse nuk ua përmbush, ai do të të qortojë pse nuk e ke orientuar kah punët e mira!
- Mos i përcill njerëzit në gabimet e tyre, por ua vëzhgo të mirat e tyre! Dhe nëse e njeh një person me të këqija, mos ia përmend ato para njerëzve, por shpreso prej tij të mirën, dhe përmende me të, përveç në fushën e fesë, që ka të bëjë me fenë e tij! Nëse këtu njeh ndonjë të keqe prej tij³, atëherë

1 Nga të këqijat dhe nga të mirat.

2 Allahu i Lartësuar thotë: “Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë. Dhe kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë.” (Kuran, 99:6-7).

3 Sikurse sajemat apo shpikjet në çështjet e fesë.

ua trego njerëzve në mënyrë që ata mos ta pasojnë atë (në atë të keqe të shfaqur), dhe të kenë kujdes prej tij¹. Pejgamberi, *salAllahu alejhi ve selem*, thotë: *“Përmendeni gjynahqarin (atë që i shfaq mëkatet) që i vepron, që njerëzit të ruhen prej tij, edhe nëse ka autoritet e pozitë!”*². Pra, tek ai që sheh defekte të shfaqura në fe, fol për to, dhe mos e ki dert për autoritetin e tij, sepse Allahun e Lartësuar e ke për ndihmës, dhe Ai do të të ndihmojë ty dhe fenë! Nëse e vepron këtë një herë të vetme, do të të respektojnë, dhe më askush nuk do të guxojë ta shfaq bidatin në fe!

- Nëse te prijësi (sulltani) sheh diç që nuk bie në përputhshmëri me dijen, përmendja atë duke mos hequr dorë nga bindja ndaj tij, sepse dora e tij është më e fuqishme sesa dora jote; thuaji atij se ti i bindesh për të vërtetën që është në të, si prijës dhe sundues yti dhe i të tjerëve, mirëpo se ia përkujton atij, nga qëndrimet e tij, edhe atë që nuk është në pajtim me dijen (Sheriatin dhe fenë)! Dhe nëse e vepron këtë me prijësin vetëm një herë, të mjafton (e ke kryer obligimin e këshillës).

1 Këtu është për qëllim që ta kesh në vëmendje qëllimin në këtë rast të këshillimit, pra le të jetë qëllim këshilla e jo hakmarrja ndaj atij personi, apo nënçmimi i tij, përndryshe je gjynahqar!

2 Hadith është i pasaktë. Këtë hadith e ka nxjerrë Ibën Ebi Dunja, në “Dhemmul Gibeh”, Hakimi, në “El Kuna”, Hakim Et Tirmidhi, në “Nevadirul Usul”, Shirazi, në “El Elkab”, prej Behëz ibën Hakimit.

Kurse me të tjerët (përsërite), sepse në këmbënguljen tënde do të ketë kthim në fe! Dhe nëse e vepron këtë një apo dy herë, bëje këtë për ta shfaqur përpjekjen tënde në fe dhe kujdesin tënd në urdhërimin për të mirë!

- Ndërsa, nëse (sunduesi) e përsërit sërish, atëherë shko futu tek ai i vetëm, në shtëpinë e tij, dhe këshilloje në fe, dhe debato me argumente nëse është në bindjen e risimtarit (jashtë rrugës së Ehlu Sunetit dhe Xhematit)! E nëse nuk është i tillë dhe takohesh me të, atëherë përkujtoja përmes këshillës, nga Libri i Allahut (aq sa të zmbrapset nga e keqja) dhe nga Suneti i të Dërguarit, *salAllahu alejhi ve selem!* Nëse e pranon, është sukses, nëse jo, atëherë lute Allahun të të ruajë prej tij (nga e keqja e tij)!
- Përkujtoje vdekjen¹, dhe kërko falje për mësuesin tënd dhe atë që prej tij i ke mësuar shkencat! Dhe lexo vazhdimisht nga Libri i Allahut, si dhe vizitoji varret më shpesh, si dhe dijetarët dhe vendet e bekuara²!

.....
 1 Pejgamberi ynë, *salAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “Përkujtojeni shkatërruesin e epsheve (pra, vdekjen)!”. Transmetues: Tirmidhiu (2307).

2 Sikur Qabënë, Xhaminë e Pejgamberit, *salAllahu alejhi ve selem* e Mesxhidul Aksanë, e assesi varret, tyrbet apo teqetë.

- Përgjigju njerëzve me komentime për ëndrrat e tyre që i paraqesin para teje, në të cilat e kanë parë Pejgamberin, *salAllahu alejhi ve selem*, dhe njerëzit e devotshëm, shtëpitë dhe varrezat (ëndrrat e mira që komentohen)!
- Mos u shoqëro me njerëzit që kanë teke, sepse ata janë qentë nga banorët e Zjarrit¹, përveçse në formë të thirrjes për në fenë e vërtetë (të Ehlus Sunetit)!
- Po ashtu, nëse te fqinji yt sheh të meta, mbuloja ato atij, sepse ai (fqinji) është amanet²! Dhe po ashtu mos i përhap sekretet e njerëzve, dhe as mos ji nga mallkuesit e ofenduesit e shpesh³, si dhe as mos u bëj fqinj i prijësit (sulltanit)! Dhe kur myezini e thërret ezanin, vrapo për të hyrë në xhami para të gjithëve, që mos të ta kalojnë të rëndomtët (e pastaj të të nënvlerësojnë)!

1 Këtu janë për qëllim havarixhët, dhe ky është përshkrimi i tyre në hadithin e Pejgamberit, *salAllahu alejhi ve selem*, siç e transmeton edhe Ibën Maxheh, në Sunenin e tij (176).

2 Këtu është për qëllim se mbulimi i turpeve të fqinjit është nga punët e mira e përgjithshme në raport me të, siç transmetohet në hadithi: “...dhe trajtoje fqinjin mirë, e do të jesh besimtar!”. Hadithin e transmeton Tirmidhiu (2305).

3 Në një hadith autentik shënohet: “Çdokush që i thotë vëllait të vet: o jobesimtar, ky ofendim do ta godasë njërin prej tyre. Nëse është ashtu siç ka thënë, e godet, e nëse nuk është ashtu, i kthehet atij (thënësit)”. Hadithin e transmeton Muslimi.

- Kush kërkon prej teje konsulta për diçka, orientoje atë me dijen që posedon, e që ty të afron tek Allahu i Lartësuar (meqë i konsultuari duhet të jetë besnik)!¹
- Dhe pranoje këtë vasijet timin, sepse (nëse i pranon dhe punon me to) do të të bëjnë dobi në dynjanë tënde (nga respekti i njerëzve dhe afrimi i tyre me ty), dhe në ahiretin tënd (duke fituar shpërblime), nëse do Allahu i Lartësuar!
- Kujdes nga koprracia, sepse ajo ta sjellë urrejtjen e të tjerëve! Dhe mos ji lakmitar e as gënjeshtar, si dhe as pështjellues (i paqartë) në fjalët tua (sepse kjo ta prish imazhin tënd), por ruaje fort prestigjin tënd në të gjitha çështjet!
- Vishu me të bardha (sa më shumë)², dhe shfaqe pasurinë e zemrës nga vetja jote, duke treguar dëshirën dhe kujdesin tënd të vogël për dynjanë! Paraqitu sikur të jesh i pasur (i panevojshëm), dhe jo sikur të jesh i varfër (meqë edhe kjo ta humb prestigjin)! Dhe tregohu njeri me ambicie e

1 Hadith sahih, të cilin e transmeton Ibën Maxheh, në Sunenin e tij, (3745), me fjalët: “I konsultuari duhet të jetë besnik.”.

2 Kështu porositi edhe Muhamedi, *salAllahu alejhi ve selem*: “*Vishni rrobat e bardha, sepse ato janë më të pastra dhe më të mira!*”. Hadithin e transmeton Ebu Davudi (3567), si dhe të tjerët.

aspirata të larta, sepse atij që i dobësohen ambiciet, i dobësohet edhe pozita!

- Kur të ecësh në rrugë, mos u kthe djathtas apo majtas, sepse kjo është shenjë e mendjelehtësisë, por vazhdimisht shiko në tokë (sikur një person modest)!
- Kur të hysh në nevojtoje, paguaje çmimin e saj më shumë sesa që japin njerëzit, që të tregohesh njeri fisnik në mesin e njerëzve, dhe kështu të të respektojnë!
- Po ashtu, ti mos i dorëzo gjësendet tua vetë, por ngarkoje dikë të besueshëm me këtë punë, pra për ta bërë për ty!
- Si dhe gjatë blerjes dhe shitjes mos u shtyj me njerëzit për copa dhe monedha të vogla, e as mos i pesho dirhemët dhe dinarët, por angazhoje dikë tjetër që këtë ta bëjë për ty, meqë kjo ta ruan pozitën tënde!
- Dynjanë, e cila është e poshtër te dijetarët (dhe tek Allahu), konsideroje njësoj edhe ti, sepse ajo që gjendet tek Allahu (nga dhuntitë e përhershme), ajo është më e mirë sesa kjo (dynjaja)!¹

¹ Pejgamberi *salAllahu alejhi ve selem*, në një hadith të qartë na e tregon vlerën e ultë të dynjasë për besimtarin. Ai, *salAllahu alejhi ve selem*, tha:

- Për punët tua mundohu në maksimum t'i angazhosh të tjerët që t'i kryejnë, në mënyrë që të jesh i lirë për t'iu përkushtuar dijes, sepse kjo edhe t'iu ruan nevojat më shumë! Dhe kujdes nga të folurit me budallenjtë dhe ata që nuk dinë të debatojnë e as nuk e njohin argumentin gjersa shtiren si të dijshëm, si dhe kujdes prej atyre që si qëllim e kanë pushtetin dhe famën, duke përmendur çështje në mesin e njerëzve, sepse qëllimi i tyre nga debati me ty është të të nxjerrin në pozita të palakmueshme (nga injoranca dhe padrejtësia e tyre), si dhe nuk kanë kurrfarë turpi prej teje, edhe nëse e dinë bindshëm se ti je në të vërtetën!
- Kur të hysh te njerëzit fisnikë, mos u ul në një vend më të lartë sesa ata, përderisa ata vetë nuk e bëjnë një gjë të tillë, që mos të të vijë ndonjë e keqe prej tyre (nga dashuria që kanë për udhëheqje)! Dhe po ashtu, nëse je te një popull, mos u dil para për t'ua falur namazin përderisa mos të të japin përparësi ata, në shenjë nderimi e respekti-sublimiteti (përndryshe do të të urrejnë)!¹

¹ “Dyngjaja është burgu i besimtarit, ndërsa Xheneti i jobesimtarit.”. Hadithin e transmeton Muslimi, në Sahih (2956), prej Ebu Hurejres, *radijallahu teala anhu*.

¹ Përndryshe, kush u del imam në namaz disa njerëzve, dhe ata e urrejnë që ai tu prijë në namaz, namazi i atij nuk pranohet, siç transmetohet me sened të saktë prej Pejgamberit, *salAllahu alejhi ve selem*, te Tirmidhiu (360), si edhe te të tjerët.

- Edhe mos e përdor banjën në kohën e pasdrekes, dhe as mes sabahut dhe lindjes së diellit! Dhe as mos dil në vendet e turpshme (ku shfaqen avretet e njerëzve), si dhe mos prezanto në vendet e padrejtësive të prijësit (sulltanit), përveç nëse je i bindur se, nëse thua diçka, ata do ta ndjekin fjalën tënde për të vërtetën. Kjo meqë, nëse ata aty veprojnë diçka nga ndalesat, dhe ti gjendesh në mesin e tyre, ndoshta ti s'ke fuqi t'i ndalësh nga ajo, e pastaj njerëzit hamendësojnë se vepra e tyre (ajo padrejtësi e ndaluar) është e vërtetë, meqë ti ke heshtur kur ata e kanë kryer atë.
- Kujdes nga hidhërimi në ndejat e dijes¹, dhe mos iu trego njerëzve tregime (përralla), sepse përrallëtari është vështirë të shpëtojë nga gënjeshttrat!
- Nëse do të marrësh pjesë në një mexhlis të ndonjë dijetari, dhe ai është mexhlis i dijes, atëherë merr pjesë vetëm, dhe përmende atë që e di nga dituria e tij, në mënyrë që njerëzit mos të mashtrohen me prezencën tënde, duke menduar se ai ka dije shumë, kurse ai nuk është i tillë! Ndërsa, nëse ai është i aftë për fetva, përmende këtë aftësi të tij!

1 Sepse kjo e pengon kuptimin e dijetarit dhe të nxënësit. Kurse, nëse hidhërimi është për shkak të kuptimit të keq të nxënësit, atëherë mund të pranohet, siç e ka shënuar edhe Buhariu, *rahimehullah*, në kapitullin e Dijes, në Sahihun e tij, në një nëntitull: “Lejesa e hidhërimit në arsimim, nëse (mësuesi) sheh ndonjë gjë të urryer”.

Përndryshe, jo! Nuk është patjetër të ulesh për të mësuar dikush prej teje, por lëre dikë prej shokëve tu të diskutojë me të, dhe ai pastaj të lajmëron për formën e tij të folurit dhe sasinë e dijes së tij!

- Mos merr pjesë në tubimet e dijes ose të këshillimit që vetëm e shfrytëzojnë prestigjin tënd dhe rekomandimin tënd para të tjerëve, por orientoju fisnikët e vendit tënd, ose edhe të rëndomtët të cilët mbështetesh, të njëri prej shokëve tu!
- Për çështjet e martesës angazhoje hatibin e lagjes tënde, e po ashtu edhe për namazin e xhenazeve dhe të Bajramit (mirëpo jo edhe të xhumasë)!
- Dhe mos më harro mua në lutjet tua, dhe pranoje këtë vasijet prej meje, sepse nuk ta kam dhënë këtë vasijet përveçse për të mirën tënde dhe për të mirën e myslimanëve!”.

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	3
Vasijeti i Imam Adhamit (Ebu Hanifes) për Ebu Jusufin	9
Përmbajta	31

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Ibën Ibrahim, Zejnulabidin

Vasijeti i imam Adhamit (Ebu Hanifes) për Ebu Jusufin / Zejnulabidin Ibën Ibrahim; me koment të Hibetullah Et Taxhi El Hanefij, rahimehullah; përktheu dhe përshtat Zejd Haziri; red. Besnik Jaha. – Tiranë: Qendra “Udha e Besimtarëve”, 2023

ISBN 978-9928-4757-3-2

1.Feja islame 2. Doktrina fetare

28 -284